

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE**, –Departamenti për Krime te Rënda, Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykues, dhe Gjyqtaret Besnik Bislimaj, dhe Malsor Kryeziu, anëtare te Trupit Gjykues, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarve T. I. M., nga fshati D. K-Rahovec, dhe te akuzuarit B. U. V. nga fshati B. K- Rahovec, për shkak te veprës penale detyrim nga neni 267 prg 2 si bashke kryes lidhur me nenin 23 te KPK-se, të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore –Departamenti për Krime te Renda ne Gjakove, PP/I.nr.222-204/2009-PZ, datë 06.06.2016, pas mbajtjes se seancave te shqyrtimeve Gjyqësore, me dt. 03.03.2017, 16.03.2017, ne prezencën e Prokurorit te Shtetit Agron Matjani, te akuzuarit T. M. dhe mbrojtësit te tij av. B. H., te akuzuarit B. V., dhe mbrojtësit te tij av. H. H., te dëmtuarve S. B. dhe F. B., dhe përfaqësuesit te autorizuarit te tyre av. A. H. nga Prizreni, me dt. 20.03.2017, muar dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:** T. M., i lindur me ....., në fshatin D. K- Rahovec, nga i ati I. dhe ëma Z. e lindura B. i martuar, i ati dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës, gjendet në paraburgim nga dt. 06.01.2017.

**II. akuzuari:** B. V. i lindur me..., në fshatin B. K- Rahovec, nga i ati U. dhe ëma B. e lindura K., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës, ka qene ne Arrest shtëpiak nga dt. 25.09.2009, gjer me dt. 20.10.2009.

**JANË FAJTOR**

Me dt. 20.09.2009, rreth orës 22:00/h, në rrugën e fshatit B. K- Rahovec, me qellim të përfitimit të kundër ligjshëm te dobisë pasurore për vete, kanosin seriozisht të dëmtuarit S B. dhe bashkëshorten e tij F. B., që të veproi ne dëm të pasurisë së vetë, duke kërkuar nga ata qe ti japin para në atë mënyrë qe deri sa te dëmtuarit ishin në makinën e tyre duke udhëtuar nga fshati B. ne drejtim te R., i akuzuari T. M. se bashku me te akuzuarin B. V., dhe një person te trete te pa njohur, ja zënë rrugën e bllokojnë dhe i akuzuari T. i afrohet te dëmtuarit S. me armë zjarri ja venë ne koke e pas kësaj e godet me koke duke i shkaktuar gjake derdhje e nxjerr nga automjeti e largon nga aty dhe e kërcënon se do te vret duke i kërkuar borxh prej 17.000 ( shtatëmbëdhjetë mije ) €, ndërsa i akuzuari B. V. i ka ndihmuar te akuzuarit T., duke kërkuar nga ai qe te ja hekën flamën e kanë kapur dhe e ka ngre ne drejtim te malit. I kanë kërkuar para dhe pas ndërhyrjes se bashkëshortes se tij dhe premtimit te saj se do ti jep para te njëjtin e lëshon dhe largon nga vendi i ngjarjes.

**- këso dore si bashke kryes kane kryer veprën penale te detyrimit nga neni 267 prg 2 lidhur me nenin 23 te KPK-se.**

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 17, 41, 43 pika 1 dhe 1.2, 45, 73, 74, prg 1, neni 83 nenit 256 prg 2 lidhur me nenin 23 te KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366, 450 te KPPK-se, te akuzuarit .

## I G J Y K O N

Te akuzuarit **T. M.**, për vepër penale detyrim nga neni 267 prg 2 si bashke kryes lidhur me nenin 23 te KPPK-se, i shqiptohet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 2 ( dy ) vite, ne te cilin dënim do te llogaritet koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 06.01.2017, gjerë në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimit, i cili nuk mund te zgjas me shume se dënimi i shqiptuar në aktgjykim.

Te akuzuarit **B. V.**, për vepër penale detyrim nga neni 267 prg 2 si bashke kryes lidhur me nenin 23 te KPPK-se, i shqiptohet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 1 ( një ) vite, e 6 ( gjashte ) muaj, ne te cilin dënim do te llogaritet koha e kaluar ne Arrest Shtëpiak, nga dt. 25.09.2009, gjer me dt. 20.10.2009.

Të dëmtuari, **S. B. dhe F. B.** udhëzohet në procedurë të rregullt civile, për realizimin e kërkesës pronësore juridike.

Të akuzuari **T. M. dhe B. V.** obligohet që ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa do te jene ne llogari te kësaj Gjykate dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumën me nga 50 ( pesë dhjete ) €. Te gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë,- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr. 222-204/09 PZ, te dt. 06.06.2016, kundër te akuzuarve T. I. M. nga fshati D. K- Rahovec, dhe të akuzuarit B. U. V. nga fshati B. K- Rahovec, për shkak se ne bashke kryerje kane kryer vepër penale te detyrimit nga neni 267 prg 2 lidhur me nenin 23 te KPK-se.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestare me dt. 18.01.2017, dhe te akuzuarit janë deklaruar te pa fajshëm për vepër penale qe i vihet ne barrë sipas aktakuzës, është caktuar seanca e shqyrtimit të dytë, dhe pas refuzimit te kërkesës për hudhjen e aktakuzës, është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor.

Përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Agron Matjani, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit Gjyqësore ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara ne seancat e shqyrtimeve gjyqësore është vërtetuar se te akuzuarit T. M., dhe B. V., ne bashke kryerje kane kryer vepër penale te detyrimit nga neni 267 prg 2 lidhur me nenin 23 te KPK-se, kjo gjendje faktike është vërtetuar nga mbrojtja e te akuzuarve deklaratave te dëmtuarve S. B. dhe F. B., te cilët i kemi marrë ne pyetje ne cilësinë e dëshmitareve nga deklaratata e dëshmitarit H. M. nga certifikata mjekësore për te dëmtuarin S. B., nga foto dokumentacioni i vendit te ngjarjes nga bisedat telefonike hyrje- dalje, dhe sms te kompanisë “Vala” bisedat e bëra ne mes te akuzuarve T. M. dhe B. V.

Sa i përket gjendjes faktike është vërtetuar se me dt. 20.09.2009, rreth orës 22:00, ne rrugën ne dalje te fshatit B. K- Rahovec, i akuzuari T. M., se bashku me te akuzuarin B. V., dhe një person te pa identifikuar me automjetin e te akuzuarit T. M., kane shkuar ne drejtim te fshatit B., dhe e kane pritur te dëmtuarin S. B., i cili ka qene te miqtë ne fshati B., për festen e bajramit, se bashku me bashkëshorten dhe dy fëmijët, dhe rrugës duke u kthyer për ne Prizren, ne dalje te fshatit ka dalë i akuzuari T. M., me automjetin e tij me ngjyre të verdh e ka bllokuar rrugën ka shkuar para derës së automjetit te të dëmtuarit S. i është afruar dhe me armë të zjarrit ka drejtuar ne drejtim të S. i ka ra ne koke ne ballë dhe nga kjo goditje ka pësuar gjakderdhje nga hunda, pastaj te njëjtin e ka nxjerr nga automjeti i ka lajmëruar aty ku i është kërcënuar se do te vret dhe i ka kërkuar borxhin ne shume prej

17.000 mije Marka Gjermane, ku i akuzuari i dytë B. V. i ka ndihmuar të akuzuarit T. M., duke e kapur përmbropa të dëmtuarin S., duke e ngreh në drejtim të malit, në atë moment e dëmtuara F. e ka lutur të akuzuarin T. që të mos e vret burrin dhe i premtonte të njëjti se ajo do të ja kryen obligimi që e ka S. ndaj T., dhe pas kësaj të akuzuarit me automjetin e T. largohen nga vendi i ngjarjes.

I akuzuari **T. M.** nuk ka mohuar faktin se i dëmtuari S. ka një borxh ndaj tij dhe se borxhi ka qene për substancë narkotike e llojit "Heroinë" në sasi prej 500 gr, e cilin narkotike S. e ka marrë nga T., e të cilën drogë S. ja ka dhënë N. K., dhe se i njëjti në vitin 2001 për këtë substancë është dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 ( dy ) vite, të cilin dënim e ka vuajtur dhe pas daljes nga burgu i akuzuari T. M. i ka kërkuar borxhe të dëmtuarit S. B. shumen prej 17.000 marka Gjermani, mirëpo i akuzuari T. M., ka pretenduar se i ka dhënë hua, mirëpo i dëmtuari S. nuk ka pranuar që të kompensoi këto para, pasi që droga i është zënë konfiskuar nga Organet e Shtetit, që ja ka shitur i akuzuari T. M., dhe për këtë arsye natën kritike i njëjti ka tentuar që me frikë të ja kompensoi shumën e kërkuar të hollave.

Sa i përket të akuzuarit **B. V.**, se ditën kritike ka qene dite feste Bajrami, është takuar me të akuzuarin T. M., i njëjti në mbrojtje ka deklaruar se nuk i kujtohet pasi që ka kaluar një kohë e gjatë, mirëpo nga mbrojtja e tij të dhënë në polici dhe në Prokurorinë e Qarkut në Prizren ka deklaruar se ditën kritike ka qene të i akuzuari T. M. për Bajram dhe se atë dite se bashku kanë pirë kafë në Rahovec, dhe sa i përket mbrojtjes së tij se ditën kritike nuk ka qene në vendin e ngjarjes respektivisht në fshatin B., të Komunës së Rahovecit, këtë mbrojtje Gjykata nuk duhet të ja fali besimin, pasi që mbrojtja e tij është e orientuar në shmangie të përgjegjësisë penale dhe kjo mbrojtje është në kundërshtim me deklaratat e dëshmitareve F. B. dhe S. B.. Ku dëshmitarja F. B., deklaratën që ka dhënë në polici dhe në Prokurori dhe në seancën e shqyrtimit Gjyqësore përshkrimin faktik të akuzuarit B. V. tiparet e tij të cilat i ka, dhe pasi që ka vërejtur disa foto në polici të njëjtin e ka identifikuar dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësore ashtu e ka konfirmuar.

Andaj i ka propozuar Gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohet sipas Ligjit për veprë penale që i vihen në barrë sipas aktakuzës.

Të dëmtuarit **S. B. dhe F. B.**, në fjalën e tyre përfundimtare kanë deklaruar se ndaj të akuzuarve i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike por për shumën nuk janë deklaruar.

Mbrojtësi i të akuzuarit **T. M. av. B. H.**, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e ngritur nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, për kinse të kryerjen e veprës penale 267 prg 2 si bashkë kryes lidhur me nenin 23 të KPK-se, nuk ka baze juridike nga se Prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë, për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë. Vërtetimi i dyshimit të bazuar është parim themelore - ligjore mbi bazën e të cilit mund të mbështete ngritja e aktakuzës e në të kundërtën ajo mund të ngel vetëm në nivelin e supozimit e asgjë me tepër. Është e vërtete që ditën kritike me 20.09.2009, në vendin dhe orën e cekur si në aktakuzë i mbrojturi im e ka ndaluar automjetin e palës kinse të dëmtuar na i cili ka kërkuar që të ja kthejë borxhin të cilin ja kishte ky i fundit. Meqë ky ka kundërshtuar atëherë ka ardhur deri të një fërkim fizik në mes tyre, pa ndonjë pasojë meqenëse pala kinse e dëmtuar nuk ka ofruar asnjë dokumentacion mjekësor relevante për lëndime. I akuzuari ditën kritike nuk kishte me vete armën apo ndonjë mjet të rrezikshëm siç pretendohet në aktakuze, dhe i mbrojturi im nuk ka qene i orientuar në detyrimin kinse të dëmtuarit për të vepruar në dem të pasurisë së tij, por vetëm ka kërkuar që të ja kthejë borxhin që ja kishte e asgjë me tepër. Në rastin konkretë nuk ka pasur përfitim të kundërligjshëm nga ana e tij, e as dem të pasurisë kinse palës së dëmtuar.

Pra arma për të cilën pretendohet se kishte i mbrojturi im natën kritike asnjëherë nuk është gjetur, edhe pse është bërë bastisja e shtëpisë së të mbrojturit tim dhe nuk është gjetur asgjë e kundërligjshëm.

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkrete nuk kemi përfitim të kundërligjshëm nga ana e të akuzuarit si dhe nuk kemi dem të pasurisë së të dëmtuarit e as përdorim të armës atëherë vlerësojmë se në veprimet e të mbrojturit tim nuk përmbushen elementet që formojnë figurën e veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, por eventualisht në rastin konkrete munde të këtë elemente të veprës penale lëndimit të lehtë trupore ose të kanosjes. Andaj në kuptim të nënti 316 prg 1 pika 4 të KPPK-se, ( i vjetri) i propozojmë Gjykatës meqenëse nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mire, Gjykata të merre aktgjykim lirues.

I akuzuari i parë **T. M.**, në mbrojtje të vete ka deklaruar, se dy vitet e fundit është i punësuar në Zvicër në punë të ndërtimitarisë, dhe se të dëmtuarin S. B. e njeh kanë qenë shokë që nga viti 2000, me të njëjtin kemi pasur raporte biznesore. Të njëjtit i kam dhënë para hua në shumë prej 15.000 marka kesh, dhe në vitin 2001, e kam qar H. M. në fshatin K. të Prizrenit, që me familjen e R. K. të djemtë e tij F. K. dhe L. K. ti marrinë 2.000€, dhe ti japin S. Këtë borxhe e kam kërkuar disa here nga S. kam qene personalisht të familja e tij, kam qene edhe te baba i tij, mirëpo paq sukses dhe kur kam shkuar te baba i tij S. me ka lutur që të mos shkoi te ai, se unë do të sqaroi këtë punë dhe se do të mi ktheje te hollat.

Ditën kritike me dt. 20.09.2009, ka qene festë ditë Bajrami, kam shkuar me familje në fshatin K. e M. K- Rahovec, dhe rastësisht e kam vërejtur S. B., i cili ka qene me makinën e tij, i cili ka qene duke shkuar në drejtim të Xërxës, i kam blinduar me drita dhe nuk me ka kthyer përgjigjen. Jam kthyer në shtëpi në fshatin Xërxë, diku rreth orës 21:30 min, me automjetin e tim kam shkuar për pjete vreshtave me makinën time “Reno Clio” me ngjyre të verdhë e kam takuar S. në hyrje të fshatit B., afër vreshtave në male. E kam ndaluar automjetin kam dalë nga makina dhe pas dy – tre minuta ka dalë bashkëshortja e tij dhe unë nuk e kam ditur që është me familje, kemi qene ballë për ballë me makinat, ka dalë nga automjeti dhe 3-4 metra mbas makinës, i jam drejtuar S., dhe i kam thënë se ku je bre S. që po me rrene, dhe tij po vozite “kabrioletë”, e unë “Reno Clio” me ka thënë se makinën ja ka ble gruaja, i kam thënë që ti e ke rregulluar shtëpinë, ndërsa unë kurrëgjë, prape ka thënë se gruaja e ka rregulluar, dhe në këtë momente ka tentuar që të më shtyje me dore, dhe unë i kam ra me koke nuk dije në cilën pjesë të përparme të kokës. Në këtë moment ka dalë gruaja e tij me një fëmijë të vogël që ka pasur në dorë me ka përbe që të lëshoi burrinë dhe kur e kam parë që është me dy fëmijët e vegjël asnjë fjalë kësaj gruaje nuk i kam thënë dhe e kam lëshuar. S. nuk e kam detyruar që të dale nga makina, ka dalë vetë, dhe kam qenë personalisht vetë, nuk ka qene kërkush tjerë dhe nga ai kam kërkuar që të më ktheje borxhin që i kam dhënë para kesh, nuk kam pasur kurrfarë armë apo mjete tjetër në dore, dhe para rastit disa here kam qene në banesën e tij dhe në familjen e tij që të kërkoi borxhin po pa suksese, dhe nga nata kritike që ka ndodhur ngjarja unë jam dorëzuar Organeve gjersa jam ndaluar në kufi duke ardhur nga Zvicra në Kosovë. Të dëmtuarit S. B. ja kam dhënë në fillim 15.000 Marka Gjermane borxh në prezencën e dëshmitarit A. H., e me vonë edhe 2.000 marka Gjermane, i ka dhënë nëpërmjet H. M., dhe këto të holla i kam dhënë pa kurrfarë interesi. Dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësore ka theksuar se i dëmtuari S. B. duhet pa tjetër të më ktheje borxhin, se nuk ka qare pa më kthye borxhin, dhe kur të dal nga burgu kam me ja que njerëz dhe çka vendosin njerëzit unë do të pranoi.

Mbrojtësit i të akuzuarit **B. V., av. H. H.**, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se, se pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore marrjes në pyetje dëshmitareve dhe leximit të provave materiale, kam menduar se Prokurori i Shtetit do të tërhiqet nga akuza ndaj të mbrojturit tim, nga se me provat e administruara në asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi im B. V., ka qene

pjesëmarrës – bashke kryes ne ketë vepër penale, e kjo mbështet nga mbrojtja e te akuzuarit T., i cili si ne seancën e shqyrtimit fillestare dhe ne shqyrtimin kryesore ka thënë se i veprën e ka kryer i vetëm, pa bashke kryes, dhe nuk ka prova qe i mbrojturi im ka qene pjesë marrës ne këtë vepër, me se mire e vërteton deklarata e të dëmtuarve te dhëne ne procedure paraprake si ne polici dhe ne Prokurori, te cilët nuk kanë thënë se i akuzuari B. V. ka qene pjesë marrës, pasi qe deklarata e dhënë ne procedure paraprake ne Polici dhe ne Prokurori, janë deklarata me te freskëta dhe të besueshme andaj duke u bazuar ne këtë i ka propozuar Trupit Gjykuese qe i njëjti të lirohet nga akuza.

I akuzuari i dytë **B. V.**, ne mbrojtje te vetë ka deklaruar se te akuzuarin e parë T. M. e kam dajë të babës, dhe se ditën kritike me dt. 20.09.2009, ka qene dite Bajrami, kam qene ne fshatin D. te Dajt te mije te B. K., për festë, me T. M. nuk jam takuar por me mesazh ja kam uruar bajramin dhe ai mue me ka uruar. Ka mohuar që natën kritike ka qene ne T. ku i njëjti është ndalur me bashkëshorten e tij. Ka pasur dijeni se i dëmtuari S. i ka pasur borxh të akuzuarit T. M., shuma ka qene 17.000 Marka Gjermane, ka deklaruar se S. B. e njeh ka ndejtur disa here me te dhe me T. M., ndërsa bashkëshorten e tij nuk e ka njohur se pari herë e ka parë ne Prokurori dhe tani ne seanca te shqyrtimit gjyqësor. Për këtë rast është iniciuar pranë Prokurorisë së Qarkut ne Prizren ku kam dhënë deklarate dhe me është shqiptuar masa e Arrestit Shtëpiak, ne kohëzgjatje prej 30 ditëve, e pas kësaj e njëjta masë është ndërpre. Ka mohuar se ka qene natën kritike me te akuzuarin e parë, dhe për rastin kam dëgjuar pas 2 – 3 ditëve, dhe për këtë me ka informuar T.

Gjykata ne cilësinë e dëshmitareve ka marrë ne pyetje te dëmtuarit S. B. dhe F. B., si dhe dëshmitarin e propozuar nga mbrojtja e te akuzuarit T. M., H. M..

Dëshmitari – i dëmtuari **S. B.**, ka deklaruar se: te akuzuarin T. M. e njeh qe nga vitin 2001 nga se me të ka pasur raporte shoqërore e me vone kane hyre ne biznes te përbashkët me substanca narkotike. Në vitin 2001 me dt. 18.09.2001, kam ra ne burg pasi qe me është zënë sasia e narkotikut ne peshe prej 1.45 gr, e llojit “heroin” nga se prej T. M. kam marrë 500 gr, te llojit “Heroin” dhe këtë narkotike ja kam dhënë N. K. nga P., ndërsa N. mi ka ndare 145 gr, te narkotikut “Heroin” e cila drogë më është zënë nga policia dhe kam ra ne burg dhe për këtë jam dënuar me 2 ( dy) vite burgim efektiv. Pasi qe kam dalë nga burgu, T. kohe pas kohe ka ardhur ne familjen time, ku kam jetuar ne lagjen “ Bashderhane” ne Prizren, ka dalë bashkëshortja dhe ky i ka treguar se është T. M., ku unë nuk kam qëlluar ne shtëpi, dhe i njëjti me ka kërkuar. Pas dy jave prape ka ardhur dhe jemi takuar me T. dhe i njëjti nga unë ka kërkuar që pjesa e mbetur e drogës që nuk më është zënë nga policia qe unë të ja ktheje te hollat, duke me kërkuar shumën prej 10.000€. Unë i kam kthyer përgjigje që drogën mund te kërkoj te N. K., ndërsa sasinë prej 145 gr, ma kane konfiskuar policia. I njëjti ka insistuar qe gjithsesi te ja ktheje te hollat dhe unë i kam thënë se nuk kam mundësi, dhe kam kërkuar nga ai që të mos vijë më në banesë.

Ditën Kritike me dt.20.09.2009, se bashku me bashkëshorten dhe dy fëmijët te moshës jo madhore me automjetin tim kemi shkuar te miqtë e mije ne fshatin B., pasi qe ka qenë festa e Bajramit. Kemi ndejtur deri ne ora 22:00/h, dhe në këtë kohe jemi nisur qe te shkojmë për në shtëpi dhe rrugës duke shkuar ne dalje te fshatit vendi është në të dy anët male nga ana e kundërt ka qene një makinë rruga ka qene e ngushtë me kane bllokuar rrugën nga automjeti ka dalë T. M. vet i treti, T. e ka hapur derën e veturës ne anën e vozitësit ku kam qene unë, dhe me ka qitur revolen ne kokë, dhe pas kësaj ne koke me ka goditur ne ballë me q rast me ka plasur gjaku dhe me ka ra terri syve. Me ka nxjerrë nga automjeti dhe me ka kërkuar para duke me thënë qiti 20.000€, në të kundërtën kam më të vra. Një person tjetër me ka ngre nga prapa me kanë shtyrë ne drejtim te malit, dhe në këtë moment ka ardhur bashkëshortja ka dalë nga makina se bashku me djalin e madhe 8 vjeçar B., dhe ju kane lutur T. që të më lëshoi dhe në këtë moment T. i është drejtuar bashkëshortes i ka thënë se a i qet ti parat për bashkëshortin, dhe bashkëshortja ime i ka kthyer përgjigje se po, dhe ne këtë moment me ka lëshuar dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes. Unë jam kthyer te miqtë e mije ne fshatin B., e kam

lajmëruar rastin dhe kam shkuar ne Stacion Policore ne Rahovec, dhe e kam paraqitur rastin. Ky person qe ne ka ngre nga mbrapa tani që e kam parë ne Prokurori dhe Gjykatë ka qene B. V., ndërsa personin e trete nuk kam mundur të identifikoi dhe i njëjti ka insistuar nga T. dhe B. që të më lëshoi, ndërsa B. i thojke T. hajde me shpejt ta heqim qafe. E kam lutur T. qe te merr automjetin veç mos me vra para fëmijëve dhe bashkëshortes. B. ne momenti kur T. me ka drejtuar revolen ne koke i njëjti me ka goditur dhe ka kërkuar nga T. qe te me heq qafe. Po atë ditë ka qenë festë e kam parë të akuzuarin T. se bashku me B. dhe një person te trete që nuk e njoh kanë pire kafe ne fshatin R., diku rreth orës 15:00/h. Kur kam ra ne burg për drogë ka ardhur në vizitë H. M., qe është dëshmitar ne këtë çështje dhe me ka thënë se T. do te me paguaj avokatinë vetëm mos të qes atë. Pasi që kam marrë ftesë për Gjykatë T. me ka dërguar njerëz së bashku me B. qe të ja fali rasti, unë i kam thënë qe këtë çështje do te ja le Gjykatës.

Gjykata ne cilësinë e dëshmitares ka marrë ne pyetje të dëmtuarën **F. S. B.**, e cila ka deklaruar.

Se më S. B. është e martuar ka dy fëmije, dhe një muaj para rastit në banesën e saj ne Prizren, ka ardhur T. M., ka trokitur e kam pyetur se çka kërkon ka vetë se ku është S.. Dhe me ka thënë që ti tregoi se po e kërkon T.

Ditën kritike me dt. 20.09.2009, ka qene ditë Bajrami, kam shkuar me bashkëshortin dhe dy fëmijët e mije me automjet ne fshatin B., te prindërit e mije për të bërë Bajram. Aty kemi qëndruar deri rreth orës 21:30 min, ne mbrëmje dhe jemi nisur te shkojmë për ne shtëpi ne Prizren, dhe nga shtëpia e prindërve kemi kaluar 1 km, kur rruga është e ngushte male është ne te dy anët kam parë që një automjet ka qene duke ardhur nga drejtimi i kundërt përball nesh dhe i kam thënë burrit largohu pak se ky nuk po dika me gra kerrit. Dhe ne këtë moment burri im është skajuar dhe ky automjet na ka bllokuar rrugën duke e ndalur automjetin përpara. Në këtë moment nga automjeti kanë dalë tre persona dhe vozitësi ka qene T., i njëjti menjëherë e ka kapur bravën e automjetit ku ka qene bashke shorti dhe bashkëshortin e kanë qitur jashtë automjetit, dhe menjëherë i kanë mësuar me koke ne ballë. Dhe në këtë rast burrit ka fillua ti dalë gjake, ndërsa revolen ja ka drejtuar ne kokë në ballë. Ndërsa personi tjetër ja ka kapur duart ja ka qitur prapa dhe e kanë qar ne drejtim të malit. Në këtë moment e kam pasur djalin në gji, i cili ne atë kohe i ka pasur 6 muaj, e kam lëshuar ne toke e kam qelë automjetin dhe ky personi i trete nuk me leke qe te dali nga automjeti. Atëherë disi kam dalë se bashku me djalin e madhe dhe kam filluar te bërtas dhe e lutesha ne çdo gjë që të lënë bashkëshortin ndërsa ky personi nuk me leke qe te shkoi ne drejtim te tyre, dhe ai person qe e ka kapur burri nga mbrapa ka qene këtu i akuzuari B. V., dhe ky i thojke T., mëshoi vraje. Ndërsa ky personi tret ka ndërhyre dhe i ka thënë qe te na leje te lirë. Në këtë moment djali i madhe 8 vjeçar, ja ka ngjitur T. ne këmbë e ka kafshuar me dhemb dhe ky e ka gjuajtur disa metra gjerë ne automjet. Bashkëshorti im e ka lutur T. duke i thënë nëse e keni ndërmend me vra mos me vritni para fëmijëve. Dhe unë në këtë moment jam ulur në toke duke ju thënë a keni zot a keni rahmet na lëshoni. T. me është ofruar dhe me është drejtuar me gishte duke me thënë “ nëse ki me mi japë 20.000€ ta lëshoi burrinë, nëse jo dije mire se kam me te kallë”. Pastaj unë ja kam kthyer përgjigje duke i thënë se besën e zotit po te jep se kam me ti dhënë parat. Pasi qe ishte ne pyetje jeta dhe ky prape me ka kthyer përgjigjen duke me thënë mendo mirë për këto fjalë që po i thua. Dhe në këtë moment e kanë lëshuar bashkëshortin te tre kanë hipur ne automjete me ngjyre te verdh i kanë shymur dritat dhe kanë shkuar ne drejtim te fshatit R.. Pas këtij rasti rastin e kemi paraqitur ne polici, kemi dhënë deklaratë mirëpo T. prej atij momenti ka qene ne arrati. Djali i madhe gjatë gjithë kohës ka bërtitur dhe ka qajtur dhe prej ati momenti është me trauma. Unë T. e kam njohur edhe me herët nga se ka ardhur ne banesën time, ndërsa këta dy persona tjetër me herët kurrë nuk i kam parë, ndërsa sa i përket te akuzuarit B. V., dhe tani kur po e shoh ne sallë shumë e sigurt jam qe ka qene ky, nga se policia te nesërmen me kane qitur shume fotografi, ku ne mesin e tyre ka qene edhe fotografia e B.. E po ashtu kur kam dhënë deklarate ne Prokurori, kur Prokurorja me ka vetë ne korridor a i ke pare këta njerëz ndonjëherë dhe kam drejtuar gishtin kah B.. Dhe ky ne këtë moment është ngritur ne këmbë dhe ka

thënë se nuk është e vërtete. Një vite pas rastit kam qenë në Qendrën tregtare “Adi” ne Prizren, duke përdorur kafe, këtu i akuzuari B. ka qenë me larg po ashtu duke përdorur kafe, dhe e kam shikuar dhe kur kam vërejtur që jam duke e shikuar menjëherë ka ikur nga aty, ndërsa personin e tretë nuk e kemi identifikuar, por ky ka qenë person që na ka shpëtuar. Pasi që ka qenë T. në banesë, e kam vetur burrinë se pse ka ardhur dhe ky me ka treguar se ky po kërkon borxhin për drogën që e ka marrë Policia dhe N. K..

Po ashtu në cilësinë e dëshmitarit është marrë në pyetje **H. H. M.**, nga Prizreni, i cili ka deklaruar se të akuzuarin T. M. e njeh është njoftuar në bazë të S. B. në vitin 2001, disa here ka përdorur kafe me të. Në vitin 2001 S. B. fqiu

im me ka kërkuar automjetin tim për shërbim ja kam dhënë dhe pas 5 -6 orë pasi që e ka marrë automjetin ka ardhur policia te unë dhe me ka pyetur se ku e kam automjetin i kam treguar se i kam dhënë S. B. në shërbim dhe këta me kanë njoftuar se automjeti është sekuestruar nga se S. i është gjetur substanca narkotike dhe se S. ka ra në burg. Pasi që S. ka ra në burg ka ardhur këtu i akuzuari T. M. është takuar me mua në Prizren, dhe ka kërkuar nga unë që kur të shkoj në vizitë të S. të mos e tregoj T. për substancë narkotike. Dhe unë së bashku me T. kemi shkruar te avokati B. N. dhe ky i ka premtuar avokatit shumën prej 10.000 marka, nëse S. e nxjerrë nga burgu. Mirëpo T. nuk ka dhënë as një cent për S.

Gjykata ka bërë leximin e provave materiale ka lexuar raportin fillestar të incidentit, raportin e policit B. K., me numër të rastit 2009- GQ-373, të dt. 25.09.2009, ka bërë shikim në hyrje – dalje të sms të kompanisë “vala” në numër të telefonit..., telefonit të akuzuarit T. M., dhe telefoni numër..., të akuzuarit B. V., ka bërë shikimin në raportin e vendit të ngjarjes me numër të rastit 2009- GC-373, të dt. 20.09.2009, ka bërë shikimin në legjendat e fotografive foto librit me numër të rastit të njëjtë, të dt. 20.09.2009, ku janë gjetur gjurmët e gjakut në vendin e ngjarjes. Ka bërë leximin e Njësisë së Teknikës Kriminologjike në Prizren, me numër të rastit 2009- 373, të dt. 22.09.2009, ku nga foto shihet pamja e njollave të ngjyrës kafe në bluzë me krahet të shkurtër e cila i takon viktimës S. B.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka nxjerrë të gjitha provat e propozuara nga Prokuroria dhe mbrojtja dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se të akuzuarit T. M. dhe B. V., me personin e tretë të pa njohur, natën kritike me dt. 20.09.2009, rreth orës 22:00, në rrugën e fshatit B. K- Rahovec, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vetë, kanë kanosur seriozisht të dëmtuarin S. B. dhe bashkëshorten e tij F. B., ku i akuzuari T. M., i armatosur me revole, ja bllokojnë rrugën të dëmtuarit S. B., se pari i mëshon me kokë në ballë, dhe revolen ia ven në kokë e nxjerrë nga automjeti këtu i akuzuari B. V., e kap nga mbrapa, e qon në drejtim të malit, dhe pas ndërhyrjes së bashkëshortes së të dëmtuarit S. dhe premtimit të saj se do të jep parat të akuzuarit, e lëshon të dëmtuarin dhe largohet nga vendi i ngjarjes, ku i dëmtuari të njëjtën natë rastin e lajmëron në Rahovec, ku është bërë shiqimi i vendit të ngjarjes.

Këto fakte Gjykata para se gjithash i ka vërtetuar nga pranimi i pjesërisht të akuzuarit T. M., i cili ka pranuar se natën kritike ja ka bllokuar rrugën të dëmtuarit S. duke pretenduar se ka kërkuar vetëm borxhin dhe ka pasur vetëm fërkim fizikë, dhe nuk ka përdorur armë dhe pasi që ka vërejtur që i njëjti ka qenë me familje të njëjtin e ka lëshuar.

Mbrojtja e të akuzuarit T. M., është në kundërshtim të plotë me deklaratat e të dëmtuarve nga se të njëjtit në mënyrë bindëse e kanë përshkruar rastin se si i akuzuari T. M. së bashku me B. V. i

kanë ndalur bllokuar rrugën e kanë maltretuar rrahur, dhe nga i dëmtuari kanë kërkuar dobi pasurore te kundërligjshëm para, dhe pas premtimit të të dëmtuarës F. B. dhe premtimit të saj se do ti jap para në një afat sa më të shkurtër i akuzuari T. e ka lëshuar të dëmtuarin S.

Nuk ka qene kontestuese që i akuzuari T. M. më të dëmtuarin S. B., kanë pasur raporte ka marrë substancë narkotike të llojit “ heroin” në sasi prej 500 gr, të cilën drogë e ka qar te N. K., sipas porosisë së T., dhe një pjesë të drogës i është zënë nga Policia te dëmtuarit S. i cili ka vuajtur dënimin për këtë veprë penale, dhe nuk e ka zbuluar te akuzuarin T. M., dhe pasi që ky ka dalë nga burgu i ka kërkuar që të ja kthejë shumën prej 15.000 marka për drogë dhe 2.000 marka, që i ka dhënë për mbrojtje, dhe se S. ka refuzuar që të ja kompensoi këtë shumë të parave. I akuzuari T. disa here ka shkuar në banesën e S. si dhe të baba i S. duke kërkuar borxhin dhe ditën kritike ka vërejtur S. që ka qene te miqtë e vetë, andaj në bashkëpunim me B. V. dhe personin e tretë, natën kritike i kanë dalë e kanë bllokuar rrugën dhe kanë ndërmarrë veprime si në aktgjykim.

Po ashtu Gjykata ka hedhur poshtë si të pa bazuar mbrojtjen e të akuzuarit B. V. nga se mbrojtja e tij është në kundërshtim me provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësorë sidomos në deklaratën e të dëmtuarës F. B., e cila në seancën e shqyrtimit kryesor ka qene kategorike duke theksuar se natën kritike ka qene edhe i akuzuari B. së bashku me T. dhe personin e tretë, të njëjtin e ka përshkuar në polici, si dhe e ka identifikuar gjatë prezantimit të fotove e kanë prekur foton e B., e po ashtu në Prokurori me ka ftuar Prokurorja dhe kur kam hyrë në korridor kanë qene 3 – 4 veta duke prituri Prokurorja me ka pyetur se mos e keni parë ndonjërin prej tyre, dhe unë jam përgjigjur po, me ka pyetur se cili është prej tyre dhe unë e ka drejtuar gjatë kah B., ky është ngritur në këmbë duke thënë se nuk është e vërtete po ashtu në seancën e shqyrtimit kryesorë dëmtuara ka qene kategorike duke theksuar se natën kritike ka qene këtu i akuzuari B. V., dhe i akuzuari B. ka tentuar të me frikësoi duke mi dërguar burra, dhe duke kërkuar që të ja fali rastin, andaj mbrojtja e tij është në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Andaj në veprimet e të akuzuarve T. M. dhe B. V. formohen të gjitha elemente qenësore të veprës penale të detyrimit nga neni 267 prg 2 si bashkë kryes lidhur me nenin 23 të KPK-se, nga se këtu të akuzuarit me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore kanë përdorur forcën dhe kanosjen serioze për të detyruar këtu të dëmtuarit që të veprojnë në dem të pasurisë së tyre, ku i akuzuari T. M. i armatosur në bashkëkryerje me të akuzuarin B. V., i cili e ka kapur viktimën nga mbrapa dhe ka kërkuar nga i akuzuari që të hëkë flamën, duke ushtruar dhunë dhe kërcënim ndaj të dëmtuarit S. B., në prezencën e bashkëshortes dhe fëmijëve të moshës jo madhore, dhe pas premtimit të bashkëshortes se S. se do ti jap të hollat që kanë kërkuar të njëjtit e kanë lëshuar. Për ekzistimin e kësaj veprë penale nuk është e domosdoshme që kryesi për vete apo për tjetrin të ketë realizuar dobinë pasurore të kundërligjshëm. Çka në rastin konkret këta nuk kanë realizuar dobinë pasurore por kanë konsumuar elemente të kësaj veprë penale, dhe në rastin konkret këtu i akuzuari T. M., duke përdorur armën dhe kërcënuar të dëmtuarin dhe duke vepruar në grup edhe me dy persona tjerë kanë kryer veprë penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitës së nënti 73 të KPRK-se, të cilat ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit, si rrethane lehtësuese ashtu edhe ato rënduese, e prej rrethanave lehtësuese Gjykata ka marrë parasysh se i akuzuari i parë është në moshë, ndërsa i akuzuari i dytë është i moshës së re, se janë të gjendjes së varfër ekonomike, i akuzuari i parë është mbajtjes i vetëm i familjes, i ati i dy fëmijëve, kurse rrethana rënduese Gjykata ka pasur parasysh peshën dhe natyrën e kësaj veprë penale e njëjta veprë penale është kryer në prezencën e fëmijëve, dhe se ky lloji i veprave penale paraqet rrezikshmëri të lartë penale, si dhe faktin të dytë të akuzuarit edhe me herët kanë qene të gjykuar. Andaj të akuzuarit e parë T. M. i ka shqiptuar dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 2 ( dy ) vite, ndërsa të akuzuarit të dytë B. V. dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 ( një ) vite e 6 ( gjashtë ) muaj, me



shpresa dhe bindje se me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare komform nënti 41 te KPK-së.

Dënimet e shqiptuara janë në harmoni me intensitetin e vlerës së mbrojtur si dhe shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe me dënimet e shqiptuara do të arrihet në parandalimin e kryerjes së veprave të këtilla apo të ngjashme penale nga i akuzuari.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve që kërkesën pasurore juridike të realizoi në kontekst të rregullt civil, bazohet në dispozitat e nenit 463 prg 2 te KPPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim, dhe në arrest shtëpiak, dënimi i shqiptuar bazohet në dispozitat e nënti 73 te KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në dispozitat e nënti 450 prg 1 lidhur me piken 2.6 te KPPK-se.

Nga se u cekë me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË, -Departamenti për Krime të Rënda  
PKR.nr.81/16, me dt.20.03.2017**

**Procesmbajtësja  
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues  
Shaqir Zika**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese në afat prej 15 dite, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.